

RREGULLORE

E

**SHOQATES KULTURORE E SHQIPTARËVE MUSLIMAN NË
HADERSDORF**

VËLLAZËRIMI

**Weinstraße 20
3493 Hadersdorf am Kamp**



**ZVR- Zahl.: 228980540
gem. § 18 Abs.3**

	<p align="center">Shoqata Kulturore e Shqiptarëve Musliman në Hadersdorf Kulturverein Albanischer Muslime in Hadersdorf A-3493 Hadersdorf am Kamp, Weinstraße 20, Tel/Fax. +43(02735) 39 921, E-mail: xhamia-hadersdorf@aon.at, xhamia_hadersdorf@hotmail.com www.radio-vellazerimi.at</p>	
	<p align="center">XHAMIA VËLLAZËRIMI KREMS 1994</p>	
<p>Version: 01</p>	<p>Datum: 22.03.2009</p>	<p>Seite 2 von 9</p>

1. Emri i Shoqatës

Emri i shoqatës është:

„SHOQATA KULTURORE E SHQIPTARËVE MUSLIMAN NË HADERSDORF“

VËLLAZËRIMI-KREMS-1994

2. Selia e Shoqatës

Selia e shoqatës është:

WEINSTRASSE. 20 A- 3493 HADERSDORF AM KAMP

3. Vula e shoqatës



Shoqata ka këtë vulë me tekstin dhe formën si vijon:

„Shoqata Kulturore e Shqiptarëve Muslimanë“

Për ndryshimet e formës dhe të tekstit të vulës së shoqatës vëndos këshilli i shoqatës

4. Hyrje

Kjo rregullore përshkruan, aktivitetet, përgjegjësitë dhe obligimet e kryesisë, gjithashtu përshkruan organizimin e punëve të xhamisë. Gjithashtu rregullon mënyrën e antarsimit në shoqatë, obligimet, detyrat dhe të drejtat e kryesisë, antarëve dhe organet e shoqatës, si dhe përdorimin e pasurisë.

Shoqata kulturore e shqiptarëve muslimanë të Hadersdorfit punon në hapësirën e Bashkësisë Islame të Austrisë me seli në Vjenë, nëpërmjet të së cilës bëhet pranimi i Imamit.

Kjo rregullore bazohet në statutet, rregullat e ligjit të shoqatave „Vereinsstatuten 2002“ të Republikës të Austrisë dhe Kushtetutën e Bashkësisë Islame të Austrisë.

	Shoqata Kulturore e Shqiptarëve Musliman në Hadersdorf Kulturverein Albanischer Muslime in Hadersdorf A-3493 Hadersdorf am Kamp, Weinstraße 20, Tel/Fax. +43(02735) 39 921, E-mail: xhamia-hadersdorf@aon.at , xhamia_hadersdorf@hotmail.com www.radio-vellazerimi.at	
	XHAMIA VËLLAZËRIMI KREMS 1994	
Version: 01	Datum: 22.03.2009	Seite 3 von 9

5. Qëllimi i Shoqatës

Shoqata ka për qëllim përhapjen dhe shpjegimin e fesë Islame, edukimin dhe shkollimin e antarëve të xhamisë, gjithashtu mbajtjen e ligjëratave fetare dhe shkencore, kujdesjen për nevojat e antarëve dhe familjet e tyre, shërbimet për varosjen e antarëve (nëpërmjet fondit të kufomave) shpjegimin e islamit dhe përmbajtjen e personave të cilët shprehin dëshirë që të marrin fenë islame si fe të tyre. Prej vitit 2009 xhamia ka edhe fondin për përgatitjen e kufomave në të cilin fond kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm antarët e shoqatës.

6. Pasuria e Shoqatës

Pasuria e shoqatës përbëhet nga:

1. Pagesa e antarësisë
2. Gjëra të lëvizshme dhe të palëvizshme, duke përfshirë edhe të ardhurat e tyre
3. Dhurata,
4. Honorare dhe shërbime të përgjithshme,
Dhurat vullnetare,
Të ardhurat nga kantina/restoranti.

Këshilli i xhamisë për harxhimet minimale (deri me 2000 euro)vendos vetë, kurse për projektet e mëdha, në konsultim me kuvendin

Këshilli i xhamisë propozon për sasinë e pagesës të antarësisë vjetore në bashkëpunim me kuvendin e përgjithshëm.

Pasuria e shoqatës lejohet të përdoret vetëm për qëllime të shoqatës ose për qëllime që vendos kuvendi i përgjithshëm në mbledhjet e rregullta apo të Jashtëzakonshme.

7. Antarësia

Antarët e shoqatës ndahen në antarë të rregullt dhe sezonalë

7.1. Antarë të rregullt janë ata antarë që japin kontribut të plotë në kryerjen e punëve të shoqatës

7.2. Antarë sezonalë janë ata antarë që gjatë kohës së qëndrimit në Austri do ta paguajnë sasinë e caktuar nga këshilli i xhamisë.

1. Të gjithë antarët obligohen që t'i përmbahen kësaj rregulloreje.
2. Të gjithë antarët do të shënohen në listën e Antaresisë.
3. Lista e antarëve aktualizohet rregullisht,mirembahet dhe ruhet nga këshilli i xhamisë.
4. Lista e antarëve përmban këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin,adresen,numrin e telefonit.,e-mail adresën.
5. Viti I antarësimi apo vitin e shkëputjes nga antarësia
6. Muslimanët që nuk janë antarë të shoqatës ose nuk jetojnë në rrethinë të kësaj xhamie kanë të drejtë të përdorin vendet fetare dhe kulturore,por duke e respektuar rregulloren dhe statutet e pergjithshme të shoqates.

	Shoqata Kulturore e Shqiptarëve Musliman në Hadersdorf Kulturverein Albanischer Muslime in Hadersdorf A-3493 Hadersdorf am Kamp, Weinstraße 20, Tel/Fax. +43(02735) 39 921, E-mail: xhamia-hadersdorf@aon.at , xhamia_hadersdorf@hotmail.com www.radio-vellazerimi.at	
XHAMIA VËLLAZËRIMI KREMS 1994		
Version: 01	Datum: 22.03.2009	Seite 4 von 9

7. Jo antarët s'kanë të drejtë të shërbehen me shërbimet fetare.. Për këto raste vendos këshilli i shoqatës në konsulltim me antarët e tjerë për dhënjen e shërbimit të kërkuar. Në këtë rastë duhet që jo antari të antarësohet duke bërë pagesën e antarësisë, më së paku një vitë më herët, prej ditës kur ka hyrë në fuqi rregullorja. dhe duke bërë pagimin e plotë të shërbimit në bazë të listës së caktuar (çmimore) nga kuvendi i përgjithshëm. Lista e shërbimeve fetare të shoqatës do ti ngjitet kësaj rregullore si shtesë

Shënim :- Në ato raste të cilët janë të punësuar dy antarë dhe secili ka familjen e vetë por jetojnë në një shtëpi të përbashkët, sipas rregullores obligohen te dy antarët (familjet) të bëjnë pagesën e antarësisë

Shënim :- Ata persona të cilët për sëpari herë deshirojnë të antarsohen në xhamin vëllazërimi por jetojnë në qytete të ndryshme dhe nuk kanë mundësi t'i kryejnë obligimet fetare, ju mundësohet që të antarësohen prej asaj kohe kur personi e plotëson formularin për antarësim

8 . Mbarimi/Lëshimi i antarësisë

Antarësia mbaron:

1. Duke bërë kërkesë me shkrim këshillit të shoqatës
2. Me ndërrim jete.
3. Me vendim të këshillit të shoqatës, në rastet kur antari bën shkelje të rënda të ligjeve fetare, shkelje të rënda të obligimeve të shoqatës, tregon sjellje të pamoralshme, shkelje të rënda ligjore apo të ngjashme. Në këto raste nevojitet 2/3 e votave të deleguarve ose të antarëve,
4. Në rast të largimit (shpërnguljes) nga vendbanimi nga rrethina e shoqatës,
5. Në rast të mospagimit të antarësisë,
6. Në këto raste këshilli i shoqatës u tërheq vërejtjen antarëve duke ju dhënë një afat kohorë (3 muaj)
7. Nëse edhe pas mbarimit të afatit tre mujorë s'është paguar antarësia, atëherë antari fshihet nga antarësia përkohësisht.
8. Në rast të riantaresimit pagesën do ta bëjë nga koha kur është larguar- distancuar.

Shënim: Largimi mund të bëhet vetëm në fund të vitit

9. Të drejtat dhe obligimet e antarëve

9.1 Antarët kanë të drejtë:

1. Të marrin pjesë në të gjithë aktivitetet, tubimet apo organizimet e ndryshme të shoqatës
2. Të shfrytëzojnë hapësirat e shoqatës, në konsulltim me këshillin e xhamisë.
3. Votë në kuvendin e përgjithshëm,
4. T'i kërkojnë këshillit të shoqatës t'i pajisë me rregullore,
5. Nëse arihet cenzusi prej 1/10 e antarëve kanë të drejtë të thirrin kuvendin e përgjithshëm,
6. Të marrin informata nga këshilli i shoqatës për punët, aktivitetet, gjendjen financiale dhe llogarritë vjetore.

	Shoqata Kulturore e Shqiptarëve Musliman në Hadersdorf Kulturverein Albanischer Muslime in Hadersdorf A-3493 Hadersdorf am Kamp, Weinstraße 20, Tel/Fax. +43(02735) 39 921, E-mail: xhamia-hadersdorf@aon.at , xhamia_hadersdorf@hotmail.com www.radio-vellazerimi.at	
XHAMIA VËLLAZËRIMI KREMS 1994		
Version: 01	Datum: 22.03.2009	Seite 5 von 9

9.2. Antarët janë të obliguar:

1. Që të mbrojnë intereset e shoqatës dhe me sjellen e vetë të mosë sjellin dëm shoqatës,
2. Të respektojnë rregulloren dhe vedimet që sillen nga organet e shoqatës,(p.sh.vendimet rreth punës së kuzhinës dhe restorantit)
3. Bëjnë pagesën e antarësisë në kohë, sasia e të cilës venëdoset nga kuvendi i përgjithshëm në takimin e rregullt vjetorë,me propozimin e këshillit.
4. Çdo antarë për çdo rast nevojë për shfrytëzimin hapsirave të shoqatës,spari herë obligohet të konsulltohet me këshillin e xhamisë (si për shembull:tubimi i ndihmave vullnetare, plakatimi i reklamave të ndryshme,shfrytëzimin parkimin të automjeteve të ç'lajmëruara,....)

10. Organet e Shoqatës

Organet e Shoqatës janë:

1. Kuvendi i Përgjithshëm
2. Këshilli i shoqatës (Kryesia)
3. Kontrolluesi Financiar
4. Këshilli i Pajtimit
5. Imami (Hoxha)
6. Komisioni i sportit
7. Komisioni i lokalit
8. Komisioni i të rinjëve

Për secilin organ dhe komision do të përgatitet rregullore pune nga këshilli i xhamisë.

10.1. Kuvendi i Përgjithshëm

Kuvendi i përgjithshëm mbledhet një herë në vitë. Një mbledhje e jashtëzakonshme e antarëve mund të thirret në rast:

1. Të vendimit të këshillit të shoqatës
2. Të kërkesës me shkrim të 30% të antarëve të shoqatës

Antarët e shoqatës lajmërohen me shkrim dy javë më parë si për mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme. Thirrja e përmban edhe rendin e ditës.

Në rend të ditës mund të vëndosen të gjithë kërkesat që parashtrohen 3 ditë para se të mbahet kuvendi i përgjithshëm.

Në kuvendin e përgjithshëm kanë të drejtë të marit pjesë të gjithë antarët e shoqatës.

Të drejtë vote kanë vetëm antarët e rregullt.

Kuvendi i përgjithshëm mund të marrë vendim me votën e 51% ëshit të antarëve të rregullt që janë prezent.

Vendimet që shërbejnë për ndërrimin e statuteve ose të mbarimit e punës të shoqatës mund të merren vetëm me dy të tretat e votave me vlerë.

	Shoqata Kulturore e Shqiptarëve Musliman në Hadersdorf Kulturverein Albanischer Muslime in Hadersdorf A-3493 Hadersdorf am Kamp, Weinstraße 20, Tel/Fax. +43(02735) 39 921, E-mail: xhamia-hadersdorf@aon.at , xhamia_hadersdorf@hotmail.com www.radio-vellazerimi.at	
XHAMIA VËLLAZËRIMI KREMS 1994		
Version: 01	Datum: 22.03.2009	Seite 6 von 9

Kuvendin e përgjithshëm e kryeson kryetari i këshillit. Nëse kryetari mungon, e zëvendëson zëvendësi i tijë. Por nëse edhe zëvendësi mungon, atëherë kuvendin e përgjithshëm e kryeson antari më i vjetër i shoqatës.

10.1.1. Obligimet / Detyrat e kuvendit të përgjithshëm

Kuvendi i përgjithshëm ka obligim për sjelljen e vendimeve që kanë domethënie të rëndësishme, si:

1. Pranimi i raportit të llogarisë vjetore ,nga kontrolluesi financiar
2. Emërimi dhe largimi i antarëve të kryesisë dhe të kontrolluesit financiar
3. Largimi i kryesisë nga detyra
4. Caktimi i sasisë së pagesës së antarësisë
5. Sjellja e vendimeve për ndërrimin e statutit të shoqatës
6. Vendosja e rendit të ditës për kuvendin e përgjithshëm

Shënim:-Pikat 2,dhe 3, realizohen vetëm në rastet kur Këshilli nuk i permbahet rregullores

10.2. Këshilli i shoqatës (Kryesia e shoqatës)

Këshilli i shoqatës përbëhet nga:

- Kryetari dhe Zëvendëskryetari
- Sekretari dhe zëvendësi i tijë
- Arkëtari dhe zëvendësi i tijë

Këshilli i shoqatës zgjedhet nga kuvendi i përgjithshëm

Kryesia e shoqatës bën emërimin e një antari të ri nëse njëri nga antarët nuk e kryen detyrën e tijë. Vendimin për emërimin e antarit të ri këshilli i shoqatës e merrë në mbledhjen e ardhshme. Nëse antari i cili mungon brenda një kohe të shkurtër nukë zëvendësohet, atëherë kontrolluesi financiar bën thirrjen e kuvendit të përgjithshëm për zgjedhjen e kryesisë së re.

1. Kryesia e shoqatës zgjidhet çdo 3 vjetë, rrizgjedhja është e mundshme. Çdo funksion kryhet personalisht
2. Kryesia mbledhet me thirrje me shkrim ose me gojë nga kryetari. Në mungesë të tijë thirren për mbledhje e bën zëvendëskryetari. Nëse është edhe zëvendëskryetari i penguar, çdo antarë i kryesisë mundë të thirrë mbledhje të këshillit të shoqatës.
3. Këshilli i shoqatës mundë të sjellë vendime, nëse të gjithë antarët janë ftuar dhe më së paku gjysma e tyre marrin pjesë
4. Këshilli i shoqatës sjell vendimet me shumicën e thjeshtë të votave. Në rast të barazimit të votive, vota e kryetarit vendos për marrjen e vendimit
5. Mbledhjet e kryesisë i kryson kryetari, e,n mungesë të tijë zëvendëskryetari. Nëse edhe ky i fundit mungon, atëherë kryeson njëri nga antarët që zgjidhet nga antarët tjerë që marrin pjesë në mbledhje

	Shoqata Kulturore e Shqiptarëve Musliman në Hadersdorf Kulturverein Albanischer Muslime in Hadersdorf A-3493 Hadersdorf am Kamp, Weinstraße 20, Tel/Fax. +43(02735) 39 921, E-mail: xhamia-hadersdorf@aon.at , xhamia_hadersdorf@hotmail.com www.radio-vellazerimi.at	
XHAMIA VËLLAZËRIMI KREMS 1994		
Version: 01	Datum: 22.03.2009	Seite 7 von 9

6. Funkzioni i një antari të kryesisë mbaron në: rast vdekjeje, të tij, porfundim të mandatit zgjedhor, në rast largimi nga funksioni ose me dorëheqjen personale të tij
7. Antarët e kryesisë kanë të drejtë që në çdo kohë të japin dorëheqje me shkrim. Kërkesa e dorëheqjes i bëhet kryesisë. Në rast të dorëheqjes të të gjithë këshillit, kërkesa i bëhet kuvendit të përgjithshëm. Dorëheqja hin në fuqi me rastin e zëvendësimit të antarit nga një antarë tjetër.

10.2.1. Obligimet / detyrat e këshillit të shoqatës

Këshilli i shoqatës ka këto obligime:

1. Udhëheqja e shoqatës
2. Administrimi i pasurisë së shoqatës,
3. Raportimi vjetor për buxhetin e shoqatës dhe planifikimi i të ardhurave dhe të daljeve të shoqatës
4. Përgatitja dhe thirrja e kuvendit të përgjithshëm
5. Informimi i antarëve të shoqatës mbi aktivitetet, vendimet e marra dhe llogarinë vjetore
6. Pranimi dhe largimi i antarëve të rregullt dhe sezonalë
7. Kujdesja për të punësuarit e shoqatës
8. Për pranimin dhe largimin e të punësuarve në shoqatë këshilli i jep propozim kuvendit..
9. Kryetari i udhëheq punët e shoqatës. Ai ndimohet nga sekretari i shoqatës
10. Në marrëdhënjet e jashtme shoqata përfaqësohet nga kryetari, apo ndonjë person i autorizuar nga kryetari
11. Kryetari dhe sekretari miratojnë dokumentet e shoqatës me nënshkrimin e tyre
12. Për rastet financiare miratimin e dokumenteve në vend të sekretarit e bën arkëtarin
13. Në rastet juridike nevojitet miratim edhe i një anarari tjetër
14. Kryetari kryeson në kuvendin e përgjithshëm dhe në mbledhjet këshillit të shoqatës
15. Çdo antarë i kryesisë para se të marrë ndonjë aktivitet duhet të konsultohet me këshillin ose së paku me kryetarin e këshillit.
16. Arkëtarin kujdeset dhe është përgjegjës për financat e shoqatës
17. Në raste të mungesës së kryetarit, sekretarit dhe arkëtarit, funksionet e shoqatës i kryejnë zëvendësit e tyre

10.3. Kontrolluesi i financave

1. Nga kuvendi i përgjithshëm zgjidhen tre kontrollorë financiarë me afatë trevjeçar
2. Kontrollorët financiarë nuk i takojnë asnjë organi, veçse kuvendit të përgjithshëm
3. Kontrollorët financiarë realizojnë kontrollin e vazhdueshëm të shoqatës, me qëllim të përmbajtjes të rregullores dhe të korrektësisë në harxhimin e mjeteve financiare të shoqatës.
4. Për kontestet mes kontrollusit financiar dhe shoqatës vendos kuvendi i përgjithshëm

10.4. Këshilli i pajtimit

Këshilli i pajtimit përbëhet nga tre antarë të shoqatës.

	Shoqata Kulturore e Shqiptarëve Musliman në Hadersdorf Kulturverein Albanischer Muslime in Hadersdorf A-3493 Hadersdorf am Kamp, Weinstraße 20, Tel/Fax. +43(02735) 39 921, E-mail: xhamia-hadersdorf@aon.at , xhamia_hadersdorf@hotmail.com www.radio-vellazerimi.at	
XHAMIA VËLLAZËRIMI KREMS 1994		
Version: 01	Datum: 22.03.2009	Seite 8 von 9

1. Këta antarë zgjidhen nga këshilli I xhamisë dhe në një afat prej tre ditëve duhet të mundohen të bëjnë pajtimin e palëve
2. Këshilli i pajtimit sjell vendimet e veta pas dëgjimit të të dy palëve me shumicën e votave
3. Këshilli i pajtimit sjell vendimet në mënyr të ndërgjegjshem. vendimet e këshillit janë përfundimtare dhe fuqiplota për antarët e shoqatës

10.5. Imami i xhamisë

Imami duhet të jetë më së paku absolvent i një shkolle të lartë islame ose të ketë një edukim-arsim të përshtatshëm fetar-islamik

Imami i përket këshillit të shoqatës vetëm në rafshin këshillues në punët e fesë dhe është referent kulturor-fetar i shoqatës

Obligimet dhe të drejtat e Imamit janë të rregulluara në ligjet e fesë islame dhe në rregulloret e dhëna nga këshilli i shoqatës.

Imami e ka për obligim të kujdeset për mirëvajtjen e jetës fetare-islame sipas rregullave islame, si brenda shoqatës ashtu edhe më gjërë

10.6. Komisioni i sportit

Ky komisioni i sportit përbëhet së paku prej tre antarëve

10.7. Komisioni i lokalit

1. Komisioni i lokalit përbëhet së paku nga tre antarë që do të kujdesen për mirëvajtjen e punës së kuzhinës dhe të lokalit
2. Komisioni i lokalit për çdo aktivitet duhet të konsultohet me këshillin e xhamisë.

10.8. Komisioni iniciativ për formimin e forumit rinorë të xhamisë

Ky komision përbëhet nga tre e më tepër antarë vullnetarë të gatshëm të japin kontributi për organizimin e rinisë tonë që jeton dhe graviton në këtë xhami

Ky komision për iniciativat e veta duhet të konsultohet edhe me këshillin e xhamisë.

Ky komision pushon së funksionuari në atë moment kur zgjidhet kryesia e forumit rinorë

Duhet të formohet edhe forumi i motrave muslimane të xhamisë



**Shoqata Kulturore e Shqiptarëve Musliman në Hadersdorf
Kulturverein Albanischer Muslime in Hadersdorf**

A-3493 Hadersdorf am Kamp, Weinstraße 20, Tel/Fax. +43(02735) 39 921,
E-mail: xhamia-hadersdorf@aon.at, xhamia_hadersdorf@hotmail.com
www.radio-vellazerimi.at



XHAMIA VËLLAZËRIMI KREMS 1994

Version: 01

Datum: 22.03.2009

Seite 9 von 9

11.Përmbajtja

1. Emri i Shoqatës.....	2
2. Selia e Shoqatës.....	2
3. Vula e Shoqatës.....	2
4. Hyrje.....	2
5. Qëllimi i Shoqatës.....	3
6. Pasuria e Shoqates.....	3
7. Antarësia	3
7.1. Antarë të rregullt.....	3
7.2. Antarë Sezonalë.....	3
8. Mbarimi/Lëshimi i antarësisë.....	4
9. Të drejtat dhe obligimet e antarëve.....	4
9.1 Antarët kanë të drejtë.....	4
9.2 Antarët janë të obliqua.....	4
10. Organet e shoqatës.....	5
10.1. Kuvendi i përgjithshëm.....	5
10.1.1. Obligimet/Deyrat e kuvendit të përgjithshëm.....	6
10.2. Këshilli i shoqatës (Kryesia e shoqatës).....	6
10.2.1. Obligimet/Detyrat e këshillit të shoqatës.....	7
10.3. Kontrolluesi i financave.....	7
10.4. Këshilli i pajtimit.....	7
10.5. Imami i xhamisë.....	8
10.6. Komisioni i sportit.....	8
10.7. Komisioni i lokalit.....	8
10.8. Komisioni iniciativ për formimin e forumit rinor të xhamisë.....	8